

30 prill 2019

Artikull nga Nand Shani, Drejtues i Ekipit të Platformës së Punësimit dhe Çështjeve Shoqërore të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC)

Historiku: Nand Shani është Drejtues i Ekipit të Platformës së Punësimit dhe Çështjeve Shoqërore, të financuar nga BE-ja dhe të zbatuar nga RCC dhe ILO, dhe që punon për përforcimin e efektshmërisë së kapaciteteve institucionale në politikat e tregut të punës për arritjen e rezultateve të mira në punësim, pra për paraqitjen e masave që synojnë t'i drejtojnë punëkërkuessit e papunë drejt vendeve të përshtatshme dhe produktive të punës.

Një vit arsimit më shumë rrit të ardhurat me 9 për qind

Në Ballkanin Perëndimor, një e punësuar mesatare humb më shumë se 30 vjet të jetës së saj produktive si pasojë e papunësisë apo pasivitetit

Në ditët tona, 1 majin e lidhim me dy ditë festë dhe një pushim të shkurtër por të merituar, piknik me miq e familje, ekskursione në vende të njohura pranë nesh, etj. Shumë pak kujtojnë origjinën e kësaj dite dhe ngjarjen e njohur tashmë si çështja apo masakra e Haymarket, që ndodhi në vitin 1886 dhe gjatë së cilës më shumë se 300.000 punëtorë në Shtetet e Bashkuara u larguan nga vendi i tyre i punës Ditën e parë të Majit të shënuar në histori, ku shumë vetë humbën jetën, por që i dha shtysë në të gjithë botën lëvizjeve sindikaliste, të cilat kërkuan të drejtat e punëtorëve dhe vendosjen me ligj të ditës së punës 8 orëshe.

Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve ose e Punës është tashmë një festë ndërkombëtare e shënuar në të gjithë botën, në nderim të përpjekjeve të punëtorëve dhe sindikatave të punës. Mbështetësit e të drejtave të punëtorëve e përdorin këtë mundësi çdo vit për të kërkuar më shumë drejtësi, kushte më të mira pune dhe përfshirje.

Këto të drejta, të paguara me gjak nga shumë punëtorë, dhe që tashmë janë pjesë e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut¹, e cila është miratuar dhe ka hyrë në fuqi gjatë Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në vitin 1948, janë vendosur dhe njihen në të gjithë botën, si dhe për ne në Ballkanin Perëndimor.

Megjithatë, ende në Ballkanin Perëndimor në zemër të Evropës, ne përballemi me papunësinë, punësimin joformal, pagat e ulëta, rrezikun e lartë për varfëri, etj.

Punësimi është i vetmi faktori më i rëndësishëm që mund t'i nxjerrë njerëzit nga varfëria. Lajmi i mirë është që më në fund, pas një dhjetëvjeçari krize ekonomike, varfëria në rajon është në rënie, kryesisht falë

¹Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, që është miratuar dhe ka hyrë në fuqi gjatë Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948 përcakton sa më poshtë:

1. Gjithkush ka të drejtën për punë, të zgjedhë lirisht profesionin, të ketë kushte të drejta dhe të favorshme pune, dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia.
2. Gjithkush, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të njëjtë të marrë rrogë të njëjtë.
3. Gjithkush që punon ka të drejtën për një shpërblim të drejtë dhe favorshëm, në mënyrë që t'i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor, dhe nëse do të jetë e nevojshme ky shpërblim të plotësohet edhe me mjete të tjera të sigurimit shoqëror.
4. Gjithkush ka të drejtë të formojë sindikatë dhe të bëjë pjesë në të për mbrojtjen e interesave të veta.

hapjes së vendeve të reja të punës. Por lajmi i keq është se varfëria është ende në nivele të larta. Sipas Bankës Botërore, në vitin 2018, shkalla mesatare e varfërisë në Shqipëri, Malin e Zi, Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Serbi kishte pësuar ulje prej 1 pikë përqindjeje vit pas viti, duke sjellë kështu një shkallë të përlogaritur të varfërisë rajonale prej 21,6 për qind. Megjithatë, shkalla e varfërisë për ata që janë të punësuar, nuk është në nivele të papërfillshme. Për shembull, ajo arrin në 9% në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe 11,9% në Serbi, duke treguar për një numër të madh vendesh pune me paga të ulëta.

Shkalla e varfërisë në 5,5 USD/ditë PPP (për qind e popullatës), vlerësimet e vitit 2018

Viti	Shqipëria	Serbia	Mali i Zi	Republika e Maqedonisë së Veriut
2012	47,5	14,5 (në 2013)	19,2	19,2
2017	35,9	22,4	4,4	21,0
2018, vlerësim	35,2	21,7	4,8	20,7

Të dhënat: Banka Botërore

Nga njëra anë, rajoni tregon shenja pozitive për sa i përket prirjeve të punësimit, sepse që prej vitit 2012 në Ballkanin Perëndimor janë krijuar më shumë se 700.000 vende të reja pune; 48% e këtyre vendeve janë plotësuar me gra, por vetëm 4,3% prej tyre me të rinj nën moshën 24 vjeçare. Në të gjashta ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, më shumë se një e pesta e të rinjve (grupmosha 15-24 vjeç) nuk janë të angazhuar në punësim, arsim, apo formim. Kjo përqindje luhetet nga 24-26% në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Kosovë*² deri në 17% në Malin e Zi dhe Serbi.

Pavarësisht prirjeve kryesisht pozitive të punësimit, është alarmante që vetëm gjysma e individëve në moshë pune në Ballkanin Perëndimor janë të punësuar. Papunësia është e lartë (rreth 17%), ndërsa pasiviteti është edhe më i lartë (38%).

Humbje të konsiderueshme në vite pune shkaktohen edhe nga mangësitë strukturore të tregut të punës. Sipas Bankës Botërore, punonjësja dhe punonjësi mesatar në Ballkanin Perëndimor humbasin përkatësisht më shumë se 30 vjet dhe më shumë se 20 vjet nga jeta e tyre produktive për shkak të papunësisë apo pasivitetit. Dhe kjo është e konsiderueshme kur kemi parasysh se jeta produktive për disa prej nesh është gjithsej 40 vjet.

Theodore Roosevelt ka thënë “Vetëm me punë e përpjekje të dhimbshme, me energji fuqiptotë dhe kurajë këmbëngulëse arrijmë gjëra të mira.” Por ne si shoqëri, si rajon, duhet të bëjmë më shumë dhe të veprojmë më shpejt për të transformuar këto shifra dhe për të arritur progres dhe rritje.

Për ta mbyllur me arsimin si një nga parashikuesit më të mirë të ecurisë së dikujt në tregun e punës, bazuar në një studim botëror të Psacharopoulos dhe Patrinos në vitin 2018, një vit më shumë arsim, rrit të ardhurat me 9 për qind! Përfitimet janë edhe më të larta për gratë dhe në vende me të ardhura të ulëta, duke treguar përsëri që arsimimi i vajzave duhet të vijojë të ketë përparësi. T’i mundësosh individëve më të cenueshëm të një vendi kapital njerëzor cilësor dhe të përforcosh aftësinë e tyre të punësimit, do të përmirësojë ndjeshëm mundësitë e tyre për të nisur një punë të qëndrueshme, e cila i paguan mirë dhe i ndihmon t’i shpëtojnë varfërisë.

²*Ky përcaktim jepet pa paragjykim për qëndrimet mbi statusin, dhe në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara Nr. 1244, dhe Opinionin e GjND-së lidhur me deklaratën e pavarësisë së Kosovës.